




REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: **IPK/27122023/DI**

Datë: **27.12.2023**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit dhe raportimit dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Menaxhimi i trafikut rrugor në Kryeqytet
Referenca	- 10/2023
Data e inicimit	- 30.08.2023
Data e raportimit	- 27.12.2023
Arsyet e inicimit	- Me datën 30 gusht 2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar fillimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm për të vlerësuar rolin policor në ofrimin e shërbimeve cilësore të policimit gjatë menaxhimit të trafikut rrugor në Prishtinë. Ky inicim ka ardhur si rezultat i informatave të pranuar mbi gjendjen shqetësuese të trafikut rrugor të qytetit dhe shkeljen e rregullave të trafikut rrugor nga ana e qytetarëve. Sipas informatave të pranuar, në situatë të tillë Policia nuk shihet askund në kryerjen e detyrave. Sipas këtyre informatave, shqetësuese është shkelja e rregullave të trafikut në disa zona të qytetit, si rezultat i ndaljes dhe parkimit vend e pavend të mjeteve.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i organizimit dhe angazhimit të burimeve njerëzore, - Vlerësimi i aktiviteteve operative në përmirësimin e gjendjes në trafikun rrugor dhe ngritjen e nivelit të sigurisë rrugore, - Vlerësimi i performancës policore lidhur me menaxhimin e trafikut rrugor, - Identifikimi i vështirësive që sfidojnë qarkullimin e duhur të njerëzve/mjeteve
Metodologjia e inspektimit	- <u>Takime - intervista</u> me katër (4) drejtues dhe bartës të funksioneve: (a) Komandanti i Stacionit Policor - Jugu, (b) Komandanti i Stacionit Policor - Qendra, (c) Komandanti i Stacionit Policor - Veriu, (d) Shefi i Operatives së Njësisë Rajonale të Trafikut Rrugor - Prishtinë; - <u>Këqyrje-verifikime</u> : të zonave specifike me vështirësi të qarkullimit në rrugë, logut operacional mbi ngjarjet ditore (reagimit), lokacioneve dhe prezencës së patrullave, planeve operative nga fusha e trafikut dhe sigurisë në rrugë, etj.; - <u>Marrje e dokumenteve</u> në formë fizike dhe elektronike, si: Lista e burimeve njerëzore nga fusha e operativës, Logu operacional i ngjarjeve ditore (muaji i fundit), planet operative në fuqi nga fusha e trafikut dhe sigurisë rrugore, oraret e patrullimit të ndërrimeve për periudhën nga 10.09.2023 - 22.09.2023, fletat patrulluese ndërmjet datave 10.09.2023 e deri me 22.09.2023, raportet e performancës në punë për periudhën janar - shtator 2023.
Subjekti	- Stacionet Policore - Jugu, Qendra dhe Veriu në Prishtinë, Drejtoria Rajonale Policore - Prishtinë.

Afatet e inspektimit	- Fillimi: 13.09.2023, - Përfundimi: 22.09.2023, - Periudha e mbulimit: muaji i fundit dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës, - PSO - Koha e reagimit (7 shtator 2018).
Ekipi realizues	- Kushtrim Jonuzi, inspektor, - Mirsad Puqurica, inspektor, - Servet Tasholli, inspektor, - Shqiponjë Sopi, inspektore, - Teuta Rukolli - Ajeti, inspektore.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miraturar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK, së
Datë	- 27.12.2023



Shkurtesat


IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
LPA	Lista e Personelit të Autorizuar
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJRTR	Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor
PSO	Procedura Standarde e Operimit
QAK	Qendra e Regjistrimit të Automjeteve
QOKR	Qendra Operative Komunikuese Rajonale

Faktet kyçe

CILA ËSHTË KOHA MESATARE E REAGIMIT NË THIRRJET E QYTETARËVE?



SA KANË QENË EFEKTIVE STACIONET PËR TË REAGUAR NË THIRRJE (%)?

CILËT JANË TRENDËT E PERFORMANCËS VARËSISHT AKTIVITETEVE PATRULLUESE?
(krahasimi janar - shtator 2022/2023)

	Patrullë me automjet	Patrullë në këmbë	Pikë kontroll	Gjoha trafiku	Trendi
Prishtinë Qendra	+2.2	+0.8	-0.2	+11.4	3(+):1(-)
Prishtinë Veriu	-38.8	+9.7	+6.9	+1.7	3(+):1(-)
Prishtinë Jugu	-34.4	-13.6	-7.8	-3.1	0(+):4(-)
Mesatarja	-31.1	-6.7	-0.1	+3.7	1(+):3(-)

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet


Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✦ Në zonat e përgjegjësisë së stacioneve dhe njërive policore, përgjatë ditëve kur është realizuar ky inspektim, ka pasur një prezencë jo të mjaftueshme të patrullave policore në mbikëqyrje të funksionimit normal të trafikut rrugor. Burimet aktive njerëzore të stacioneve momentalisht nuk janë të mjaftueshme për t'iu dhënë zgjidhje problemeve dhe nevojave të trafikut. Janë evidentuar raste kur në mungesë të tyre, patrullat janë vonuar në reagim, apo nuk kanë reaguar fare.
- ✦ Përkundër ngarkesës së dukshme në punë që kanë njësitë operative, duhet shtuar veprimet reaguese në aplikimin e masave ndaj shkelësve të rregullave të trafikut, kryesisht ndaj atyre që kryejnë parkime të parregullta dhe bllokojnë trotuarët. Janë identifikuar edhe disa situata kur thirrjet e pranuar nga qytetarët në përfundim të ndërrimeve, nuk janë adresuar në mënyrën e duhur.
- ✦ Bazat e radio - komunikimit pasqyrojnë një cilësi të ulët të evidencës së logut operacional të ngjarjeve ditore. Koha mesatare e reagimit të patrullave policore në thirrjet e qytetarëve (të tipit “aksident” dhe “komunikacion”) rezultojnë të jetë më e zgjatur krahasuar me matjet në nivel vendi. Shumica e indikatorëve mbi aktivitetin patrullues tregojnë për rënie të performancës policore.



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore (Qendra, Jugu dhe Veriu të Prishtinës) dhe Udhëheqësit të Njesisë së Trafikut për Kryeqytetin, të mobilizohen në shtimin e aktiviteteve patrulluese në akset kryesore të Kryeqytetit, që shfaqin vështirësi në qarkullimin normal të komunikacionit rrugor.
2. IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore (Qendra, Jugu dhe Veriu) dhe Udhëheqësit të Njesisë së Trafikut për Kryeqytetin, që të nxisin njësitë patrulluese në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme operative ndaj ngasësve të mjeteve që parkojnë mjetet në mënyrë të parregullt në vendet e ndaluara (veçanërisht në trotuarët e dedikuara për këmbësorë).
3. IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës (Qendra, Veriu dhe Jugu), që të ndërmarrin veprimet e nevojshme mbikëqyrëse mbi zyrtarët e bazave të radio-komunikimit, për përmirësimin e cilësisë së logut operacional, drejt eliminimit të mangësive për evidentimin e plotë të shënimeve brenda tij.
4. IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës (Qendra, Veriu dhe Jugu) që të ndërmarrin masat e nevojshme të mbikëqyrjes, në drejtim të shkurtimit maksimal të kohës së reagimit (arritjes në vendngjarje) të njërive patrulluese.
5. IPK-ja u rekomandon komandantëve dhe shefave të operativës së stacioneve (Qendra, Veriu dhe Jugu), që të shtojnë mbikëqyrjen dhe të kërkojnë nga vartësit e tyre që të reagojnë shpejtë për të gjitha thirrjet e pranuar, pavarësisht momentit të pranimit të thirrjeve, kur ato të jenë edhe në fund të orarit të ndërrimit.
6. IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës së stacioneve policore (Veriu dhe Jugu) që të ndërmarrin masat e nevojshme të mbikëqyrjes mbi ekipet patrulluese, në drejtim të shtimit të patrullimeve me automjete në zonat e përgjegjësisë së tyre.

<p>Gjetjet kryesore:</p> 	<p>1. Vështirësitë që pengojnë gjendjen normale në trafik</p> <p>1.1. Në periudhën kohore 13.09.2023 - 21.09.2023, Departamenti i Inspektimeve i IPK-së ka vrojtuar nga afër rrjedhën e zhvillimit të trafikut rrugor në zona specifike të Kryeqytetit, për të cilat ka pasur indikacione se karakterizohen me vështirësi të qarkullimit rrugor. Zonat që kanë qenë objekt i këtij monitorimi kanë përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Segmentin që përshkon rrugën nga Udhëkryqi pranë Furrës “Qerimi” deri te Rrethi rrotullimi që lidhet me Rrugën C (13.09.2023), (b) Segmentin që përshkon rrugën nga Udhëkryqi pranë Qendrës së Studentëve deri tek Xhamia e Llapit pranë Hekurudhës (14.09.2023), (c) Segmentin që përshkon rrugën nga Rreth rrotullimi pranë Shkollës së Mesme të Mjekësisë deri tek Katedralja “Nënë Tereza” (15.09.2023), (d) Segmentin që përshkon rrugën nga Udhëkryqi pranë Kompleksit “Qafa” deri tek Hotel Prishtina (18.09.2023), (e) Segmentin që përshkon rrugën nga Udhëkryqi pranë Kompleksit “Santea” deri tek Rreth rrotullimi pranë Stacionit të Autobusëve (19.09.2023), (f) Segmentin që përshkon rrugën nga Udhëkryqi pranë Ndërtesës së Agjencisë së Regjistrimit Civil deri tek Rreth rrotullimi i Arbërisë (20.09.2023), (g) Segmentin që përshkon Rrugën “B” dhe “Muharrem Fejza” deri tek Rreth rrotullimi pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (21.09.2023). <p>1.2. Monitorimi i gjendjes së trafikut ka identifikuar disa zona apo akse rrugore që karakterizohen me problematika dhe vështirësi në mbarëvajtjen dhe qarkullimin rrugor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Akset rrugore të cilat lidhen te Rrethi i Flamurit në të gjitha drejtimet përbëjnë zonën më të ngarkuar dhe me vështirësi në trafik, si rezultat i fluksit të madh të mjeteve, që hyjnë nga akset periferike dhe i qasen Qendrës dhe anasjelltas, - Zona përgjatë segmentit rrugor “Muharrem Fejza” ka vështirësi në rrjedhën normale të qarkullimit si rezultat i numrit të madh mjeteve dhe mungesës së kapacitetit të korsive që ofron ky aks. - Zona përgjatë segmentit rrugor nga Udhëkryqi tek “Sante” deri tek Rrethi i rrotullimit pranë Stacionit të Autobusëve është problematike me një numër të madh mjeteve dhe ngecje në qarkullim normal të trafikut. - Zona përgjatë segmentit rrugor nga “Qafa” deri tek Hotel Prishtina gjithashtu paraqet një nga zonat problematike, ku frekuenton numër i madh mjeteve nga shumë akse periferike që hyjnë në qytet dhe i qasen Qendrës dhe anasjelltas. <p>1.3. Akset rrugore që lidhen me Rrethin e Flamurit gjatë intervalit kohor 07.30-08.30 të mëngjesit dhe 14.30-18.00 të pasdites përballen me një prezencë të madhe mjeteve, me çka dhe paraqiten vështirësi në qarkullimin. Rruga “Muharrem Fejza” përballlet me rrjedhë të vështirësuar të qarkullimit si rezultat i numrit të madh të mjeteve që qarkullojnë nëpër këtë aks. Në Aksin rrugor nga Udhëkryqi tek Sante deri tek Rreth Rrotullimi në Lakërishtë dhe rrugën “Eqrem Qabej” janë evidentuar disa lokacione ku për shkak të ndalesave të shpeshta të makinave dhe parkimit të makinave anash rrugës, është penguar qarkullimi rrugor. Makina të parkuara ka pasur dhe te hyrja e Kurrizit përballë Viva - Fresh dhe afër Xhamisë në Lakërishtë, që kanë shkaktuar vështirësi në trafik. Në disa raste janë hasur patrulla policore tek Rrethi i Flamurit, që janë kujdesur për rregullimin e trafikut, ndërsa në lokacionet tjera të karakterizuara me vështirësi të qarkullimit nuk është vërejtur angazhim i tillë policor.</p> <p>1.4. Ndaljet dhe parkimet e parregullta të mjeteve në mjedise jo adekuate kanë shkaktuar pengesa në rrjedhën normale të qarkullimit rrugor në Kryeqytet. Makina të parkuara janë hasur nga Sheshi “Bill Klinton” në drejtim të Santesë, në zonën tek Objekti i Avokatit të Popullit ish Banka e Lubjanës, Zona rreth Hotel Prishtinës ku janë edhe kompanitë e sigurimit të automjeteve, në rrugën “Eqrem Qabej” afër Shkollës</p>
---	--

“Ismajl Qemali” dhe në Rrugën “Muharrem Fejza”. Për shkak të parkimit të mjeteve nëpër trotuare është vështirësuar lëvizja e këmbësorëve, duke i detyruar ata që të lëvizin në korsinë e mjeteve, duke penguar kështu qarkullimin e mjeteve, por duke cenuar edhe sigurinë e tyre. Gjatë monitorimit në këto lokacione, nuk janë hasur patrulla duke intervenuar ndaj ngasësve, që kishin parkuar makinat e tyre në mënyrë të parregullt, në vende të ndaluara dhe trotuare të dedikuara për këmbësorë.

1.5. Është vërejtur se një ndër faktorët që shpesh ndikon në mbarëvajtjen e trafikut është dhe zhvillimi i punimeve përgjatë disa akseve rrugore në Kryeqytet, sidomos gjatë orëve të ditës kur fluksi i lëvizjes së mjeteve është më i dendur. Në ditën kur është zhvilluar inspektimi nga drejtimi i Katedrales, në afërsi të Ndërtesës së Ministrisë së Financave dhe në Aksin rrugor të Udhëkryqi pranë Santesë, për shkak punimeve në rrugë ka pasur rrjedhë të vështirësuar të qarkullimit në këtë pjesë.

1.6. Në zonën përgjatë segmentit rrugor që shpie nga ish Banka e Lubjanës, kah lagjia Arbëria (ish Dragodan), gjatë kohës së inspektimit është hasur në një rast aksidenti në komunikacion, me çrast ishte shkaktuar kolonë e gjatë automjeteve, por patrulla kishte arritur në kohë relativisht të shpejtë dhe ka trajtuar rastin.

2. Organizimi dhe burimet njerëzore të njësisë policore

2.1. Zona urbane e Kryeqytetit të Prishtinës¹ përfshinë rreth 60 km² të territorit të Komunës së Prishtinës e që përbën zonën më numrin më të madh të banorëve dhe njëri ndër qytetet me karakteristika të veçanta, si qendër më e madhe ekonomike, administrative, edukative e kulturore në vend. Ka infrastrukturë jo të mjaftueshme rrugore në raport me numrin e madh të mjeteve që lëvizin gjatë ditës. Kjo situatë krijon ngarkesë të jashtëzakonshme në qarkullimin rrugor dhe atë kryesisht gjatë kohës së fillimit dhe mbarimit të orarit të punës të të punësuarve. Sipas statistikave të QRA, në territorin e Kosovës janë të regjistruara mbi 400.000 vetura, ndërsa vetëm në Rajonin e Prishtinës janë të regjistruara mbi 160.000 vetura (40% e totalit të përgjithshëm). Vetëm nëpër rrugët e Prishtinës brenda 24 orëve qarkullojnë mbi 120.000 vetura. Veç lëvizjes së madhe të automjeteve, ka lëvizje të madhe edhe të këmbësorëve, të cilët në mungesë të funksionimit të semaforëve në disa vende gjatë lëvizjes pandërprerë krijojnë vështirësi në qarkullimin normal të automjeteve. Kur kësaj i shtohen parkimet e parregullta në trotuare dhe ndalesat e vazhdueshme të mjeteve transportuese, atëherë gjendja në trafik bëhet edhe më e rënduar.

2.2. Akter kyç që përkujdeset për mbarëvajtjen e trafikut rrugor në Kryeqytet është Policia e Kosovës, e cila është e autorizuar të ndërmarrë aktivitete për lehtësim dhe funksionim normal të komunikacionit. Në bazë të karakteristikave dhe veçorive të Kryeqytetit dhe zonën urbane të tij është përcaktuar organizimi policor dhe ndarja e kompetencave dhe përgjegjësisë lidhur me trafikun rrugor. Bazuar në Strukturën organizative të Policisë së Kosovës, zona urbane e Prishtinës është ndarë ndërmjet stacioneve policore të rendit: Prishtinë Qendra, Prishtinë Jugu dhe Prishtinë Veriu në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Prishtinës. Veç kësaj, për shkak të veçorive dhe karakteristikave të cekur më lartë, në kuadër të NJRTR - Prishtinë është strukturuar dhe Njësi policor i Kryeqytetit, që merret me menaxhimin dhe sigurimin e trafikut rrugor në Kryeqytet, duke u angazhuar në rregullimin dhe lehtësimin e qarkullimit të komunikacionit nëpër udhëkryqe (rreth-rrotullime dhe kryqëzimet e mëdha), me qëllim të shmangies së pengesave në trafik dhe parandalimin e aksidenteve.

2.3. Meqenëse elementi më i rëndësishëm i organizatës janë burimet njerëzore, të cilat paraqesin një vlerë qenësore, shtrohet nevoja për organizimin e shpërndarjen e mirëfilltë të tyre. IPK ka pasur në dispozicion oraret e ndërrimeve për periudhën 10.09.2023-22.09.2023 dhe ka analizuar kapacitetet operative aktive për periudhën

¹ Bazuar në të dhënat e siguruar nga NJRTR - Prishtinë.

referuese². Stacionet policore aplikojnë orar pune në tre ndërrime (A, B dhe C) me nga tetë (8) orë brenda ciklit prej 24 orëve. Ndërrimi i parë (paradite) operon në periudhën 07.00-15.00, ndërrimi i dytë (pasdite) operon në periudhën 15.00-23.00 dhe ndërrimi i tretë (natën) operon në periudhën 23.00-07.00. Njësia e Trafikut të Kryeqytetit aplikon orar pune në dy ndërrime (A dhe B) me nga tetë (8) orë brenda ciklit prej 24 orëve. Ndërrimi i parë (paradite) operon në periudhën 07.00-15.00, ndërrimi i dytë (pasdite) operon në periudhën 15.00-23.00, ndërsa gjatë ndërrimit të tretë (natën) në periudhën 23.00-07.00 nuk aplikohen patrullime në Kryeqytet. Nëse analizojmë kapacitetet aktive policore për periudhën referuese (10.09.2023 - 22.09.2023), nëpër stacione policore pasqyrohen këta tregues (indikatorë):

- Prishtinë - Qendra në bazë të orareve të tre (3) ndërrimeve, ka pasur fuqi aktive mesatare prej 18 zyrtarësh policor në ndërrimin e parë, 23.5 zyrtarësh policor në ndërrimin e dytë dhe 19 zyrtarësh policor në ndërrimin e tretë.
- Prishtinë - Veriu në bazë të orareve të tre (3) ndërrimeve, ka pasur fuqi aktive mesatare prej 10.7 zyrtarësh policor në ndërrimin e parë, 14.5 zyrtarësh policor në ndërrimin e dytë dhe 14.5 zyrtarësh policor në ndërrimin e tretë.
- Prishtinë - Jugu në bazë të orareve të tre (3) ndërrimeve, ka pasur fuqi aktive mesatare prej 24 zyrtarësh policor në ndërrimin e parë, 27 zyrtarësh policor në ndërrimin e dytë dhe 21 zyrtarësh policor në ndërrimin e tretë.
- Njësia e Trafikut të Kryeqytetit në bazë të orareve të dy (2) ndërrimeve, ka pasur fuqi aktive mesatare prej 12.2 zyrtarësh policor në ndërrimin e parë dhe 13.2 zyrtarësh policor në ndërrimin e dytë.

2.4. Stacionet policore kanë për detyrë të mbulojnë zonat e tyre të përgjegjësisë me patrulla policore, që duhet të jenë të angazhuara 24 orë. Këto njësi që merren me rregullimin dhe sigurinë e komunikacionit rrugor, me orar ditor i kanë të përcaktuar detyrat e planifikuara që duhet realizuar gjatë ndërrimit, përfshirë patrullimet dhe pikat e kontrollit. IPK-ja ka pasur në dispozicion oraret e ndërrimeve për periudhën 10.09.2023-22.09.2023 dhe ka analizuar kapacitetet patrulluese në kuadër të tre (3) ndërrimeve brenda 24 orëve. Inspektimi pasqyron se nga stacionet policore është organizuar ky kontingjent patrullash policore në periudhën referuese:

- Prishtinë - Qendra në tre (3) ndërrimet ka operuar me nga tre (3) deri në gjashtë (6) patrulla, në përbërje me nga dy (2) dhe tre (3) zyrtarë policor për njësi.
- Prishtinë - Veriu në tre (3) ndërrimet ka operuar me nga dy (2) deri në pesë (5) patrulla, në përbërje me nga dy (2) dhe tre (3) zyrtarë policor për njësi.
- Prishtinë - Jugu në tre (3) ndërrimet ka operuar me nga katër (4) deri në tetë (8) patrulla, në përbërje me nga dy (2) dhe tre (3) zyrtarë policor për njësi.
- Njësia e Trafikut të Kryeqytetit në dy (2) ndërrimet ka operuar me nga katër (4) deri në tetë (8) patrulla, në përbërje me nga dy (2) e tre (3) zyrtarë policor për njësi.

2.5. Stacionet policore me këto njësi patrulluese gjatë ndërrimeve kanë mbuluar zonat e përgjegjësisë së tyre (urbane dhe rurale), duke kryer aktivitete patrulluese të planifikuara me orare ditore, duke qenë në dispozicion të përgjigjen në të gjitha thirrjet, të cilat kërkojnë reagim policor. Aktivitetet patrulluese në zonë urbane në rrugët e Kryeqytetit, stacionet policore i kanë realizuar me automjetet dhe në këmbë, duke aplikuar patrullimet në lëvizje dhe pikat e kontrollit.

3. Performanca e njësive policore

3.1. Në Raportin e inspektimit lidhur me “Menaxhimin e thirrjeve dhe reagimit policor”, i dalur nga inspektimi i realizuar në të gjitha stacionet, janë pasqyruar dobësi

² Në kuadër të orareve të ndërrimeve përfshihet personeli operativ i ndërrimeve, pa përfshirë stafin tjetër, i cili punon me orar të rregullt administrativ 08:00-16:00.

në mbajtjen e logjeve operacional³, ku edhe IPK iu kishte rekomanduar komandantëve të stacioneve policore, shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të ushtrojnë kontrole të shtuara, duke përfshirë edhe auditime të planifikuara periodike mbi zyrtarët që mbajnë logjet, drejt ngritjes së cilësisë së evidencës. Logu mbahet nga Zyrtarët e Bazave të Radio - Komunikimit dhe sipas drejtuesve, ato kontrollohen kohë pas kohe, por që nuk dokumentohet me shkrim. Gjatë këtij inspektimi, IPK ka siguruar logjet e tre (3) stacioneve policore për periudhën 10.09.2023 - 22.09.2023, për t'u siguruar se evidenca është cilësore, e përditësuar më të dhëna mbi thirrjet dhe reagimin policor. Inspektimi vë në pah se për thirrjet dhe reagimin mbahet evidencë në log, por edhe përkundër vërejtjeve të mëhershme, në këto stacione nevojitet të sigurohen të dhëna më të azhuruara, meqë thirrjeve nuk iu pasqyrohet koha e arritjes në vendin e ngjarjes. Rubrikat adekuate për shënimin e detajeve rreth kohës së reagimit dhe arritjes në vendin e ngjarjes, kanë qenë të zbrazëta, por detajet për kohën e reagimit shënohen tek rubrikat e përshkrimit të komunikimit të patrullave me bazën e stacioneve (si rasti i Prishtinës - Qendra). Ndërsa, tek Prishtinë - Jugu, veç rubrikave adekuate të zbrazëta, koha e reagimit e njësisë dhe detajet për arritje në vend ngjarje, rrallë janë shënuar.

3.2. Gjatë këtij inspektimi, IPK-ja ka pasur në fokus reagimin policor në thirrjet e qytetarëve dhe për të konstatuar efektivitetin e njësisë policore, janë kontrolluar një numër mostrash të ngjarjeve ku ka pasur reagim⁴. Nga analiza e mostrave të thirrjeve, të realizuara nga stacionet përgjatë periudhës 10.09.2023 - 22.09.2023, rezultojnë këta indikatorë:

- Në Logun operacional të Prishtinës - Qendra, nga 908 thirrje qytetarësh të tipeve të ndryshme që kanë kërkuar reagim policor, 513 sish (56.5%) kanë qenë të tipit (natyrës) të komunikacionit. Në 471 nga 513 thirrje të kësaj natyre (91.8%), njësitë policore të këtij Stacioni janë përgjigjur (reaguar), derisa në 42 nga 513 thirrje (8.2%) nuk ka pasur reagim policor.
- Në Logun operacional të Prishtinës - Veriu, nga 284 thirrje qytetarësh të tipeve të ndryshme që kanë kërkuar reagim policor, 106 sish (37.3%) kanë qenë të tipit (natyrës) të komunikacionit. Në 87 nga 106 thirrje të kësaj natyre (82.1%), njësitë policore të këtij Stacioni janë përgjigjur (reaguar), derisa në 19 nga 106 thirrje (17.9%) nuk ka pasur reagim policor.
- Në Logun operacional të Prishtinës - Jugu, nga 1.233 thirrje qytetarësh të tipeve të ndryshme që kanë kërkuar reagim policor, 640 sish (51.9%) kanë qenë të tipit (natyrës) të komunikacionit. Në 600 nga 640 thirrje të kësaj natyre (93.7%), njësitë policore të këtij Stacioni janë përgjigjur (reaguar), derisa në 40 nga 640 thirrje (6.25%) nuk ka pasur reagim policor.

3.3. Inspektimi i shënimeve të logut operacional në tre (3) stacione policore veç tjerash gjeti se tek një numër i konsiderueshëm i thirrjeve të pranuar në orën e fundit të përfundimit të ndërrimit, është dukuri dhe praktikë që reagimi policor t'i bartet ndërrimit pasues.

3.4. IPK ka analizuar numrin e thirrjeve, të cilat kanë kërkuar reagim policor, me theks të veçantë thirrjet e natyrës së komunikacionit që lidhen me problematikat e sigurisë në rrugë. Me qëllim të vlerësimit të ngarkesës dhe kohës së reagimit⁵ të njësisë policore, janë kontrolluar logjet operative të tre (3) stacioneve që operojnë në zonën e Kryeqytetit për periudhën kohore 10.09.2023-22.09.2023. Nga analiza e mostrave të

³ Logu është pasqyrë e krijuar elektronike, me shkrim, ku evidentohen informimet telefonike zyrtare të pranuar nga cilido informues i mundshëm, për një ngjarje të caktuar të ndodhur më parë, apo që është në zhvillim e sipër.

⁴ Koha e reagimit llogaritet nga pranimi i informatës nga QOKR-ja, mbikëqyrësi, apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla apo njësitë që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njësisë së ngarkuar dhe arritja në vendngjarje.

⁵ PSO përcakton që koha e reagimit për zonat urbane të jetë maksimum 15 minuta dhe për zonën rurale maksimum 30 minuta, varësisht lokacionit ku ndodhë rasti (me përjashtim në disa zona të thella malore dhe me kushte të pa përshtatshme atmosferike).

thirrjeve rezulton se:

- Nga 513 thirrje të natyrës së komunikacionit (tipi “aksident” dhe “komunikacion”), të administruara nga Prishtinë - Qendra, për 31.7% të tyre është arritur të nxirren shënime për kohën e reagimit të njësisë në vendin e ngjarjes. Bazuar në këto thirrje, Stacioni ka një kohë mesatare prej 18.9 minuta të arritjes në vendngjarje.
- Nga 106 thirrje të natyrës së komunikacionit (tipi “aksident” dhe “komunikacion”), të administruara nga Prishtinë - Veriu, për 68% të tyre është arritur që të nxirren shënime për kohën e reagimit të njësisë në vendin e ngjarjes. Bazuar në këto thirrje, Stacioni ka një kohë mesatare prej 17.1 minuta të arritjes në vendngjarje.
- Nga 640 thirrje të natyrës së komunikacionit (tipi “aksident” dhe “komunikacion”), të administruara nga Prishtinë - Jugu, për 5.9% të tyre është arritur që të nxirren shënime për kohën e reagimit të njësisë në vendin e ngjarjes. Bazuar në këto thirrje, Stacioni ka një kohë mesatare prej 16.3 minuta të arritjes në vendngjarje.

Tabela nr. 1 - Pasqyrë mbi reagimin në thirrjet e qytetarëve (10.09.2023 - 22.10.2023)

Stacioni	Thirrje sipas logut	Thirrje të tipit “aksident” dhe “komunikacion”	Thirrjet me reagim	Thirrjet pa reagim	Reagimi mesatar (minuta)
Qendra	908	513	471	42	18.9
Veriu	284	106	87	19	17.1
Jugu	1.233	640	600	40	16.6
Totali	2.425	1.259	1.158	101	17.5

3.5. Bazuar në nenet 29, 30, 31 dhe 32 të Rregullores për Personel e Administratë në Policinë e Kosovës, policët/rreshterët/togerët dhe kapitenët kanë përgjegjësi të raportimit, varësisht pozitave të tyre drejtuese. IPK ka verifikuar nëse zyrtarët e këtyre stacioneve dhe Njesisë së Trafikut për Kryeqytetin, kryejnë raportimet e nevojshme sipas detyrave të parapara dhe nëse ato kryhen me kohë. Janë siguruar raportet e patrullave mbi ngjarjet e ndërrimeve për periudhën kohore 10.09.2023-22.09.2023, ku janë përfshirë fletë patrullat. Vihet re se zyrtarët policor përpilojnë raporte për detyrat e realizuara të ndërrimit, që inspektohen nga mbikëqyrësit dhe bëhen pjesë e Raportit 24 orë në nivel të Stacionit.

3.6. Për të krahasuar treguesit e performancës që lidhen me aktivitetet patrulluese të njësisë policore të tre (3) stacioneve policore, IPK është shërbyer me të dhënat e raporteve periodike për periudhën nëntëmujore (janar-shtator 2023). Ndërsa sa i përket aktivitetit të Njesisë së Trafikut për Kryeqytet nuk është arritur të nxjerren të dhënat për këtë periudhë, për shkak se të dhënat mbi aktivitetet e kësaj Njësie janë pjesë e raportimit të përbashkët të NJRTR - Prishtinë. Në këtë mënyrë ka qenë e pamundur të veçohen (ndahen) të dhënat mbi aktivitetet e Njesisë së Trafikut për Kryeqytet, nga të dhënat e Raportit periodik të NJRTR - Prishtinë.

3.7. Patrullat kryejnë patrullime me automjete dhe në këmbë, por organizojnë edhe pika kontrolli. Në trafik shkaktohen kundërvajtje, për të cilat stacionet shqiptojnë gjoba në drejtim të ngritjes së sigurisë rrugore. Neni 10 i Rregullores për Operativë përcakton që ndalja e automjetit për shkak të kundërvajtjes në trafik, apo për qëllime tjera, në të shumtën e rasteve konsiderohet si detyrë e rregullt e zyrtarëve policor patrullues. Realizimi i patrullimeve dhe pikave të kontrollit varet nga një sërë faktorësh dhe nuk ka një metodologji të caktuar se si duhet kombinuar këto aktivitete në funksion të ngritjes së sigurisë rrugore. Stacionet policore hartojnë raporte periodike, me analiza mbi aktivitetet që zhvillojnë njësitë policore për zonat e tyre të përgjegjësisë. Nga analiza e treguesve të performancës për periudhat nëntë mujore janar-shtator 2022 dhe 2023 rezulton se:

- Prishtinë - Qendra ka pasur ngritje për +0.8% të numrit të patrullimeve në këmbë, ngritje për +2.2% të numrit të patrullimeve me automjet, rënie për -0.2% të numrit të pikave të kontroleve dhe ngritje për +11.4% të numrit të gjobave të shqiptuara

(shikuar raportin ndërmjet numrit të gjobave të shqiptuara me numrin e zyrtarëve policor rezulton se një polic i Stacionit ka shqiptuar mesatarisht 70.7 gjoba trafiku).

- Prishtinë - Veriu ka pasur ngritje për +9.7% të numrit të patrullimeve në këmbë, rënie për -38.8% të numrit të patrullimeve me automjet, ngritje për +6.9% të numrit të pikave të kontrolleve dhe ngritje për +1.6% të numrit të gjobave të shqiptuara. (shikuar raportin ndërmjet numrit të gjobave të shqiptuara me numrin e zyrtarëve policor rezulton se një polic i Stacionit ka shqiptuar mesatarisht 65.7 gjoba trafiku).

- Prishtinë - Jugu ka pasur rënie për -13.6% të numrit të patrullimeve në këmbë, rënie për -34.7 % të numrit të patrullimeve me automjete, rënie për -7.8% të numrit të pikave të kontrolleve dhe rënie për -3.0 % të numrit të gjobave të shqiptuara. (shikuar raportin ndërmjet numrit të gjobave të shqiptuara me numrin e zyrtarëve policor rezulton se një polic i Stacionit ka shqiptuar mesatarisht 57.7 gjoba trafiku).

Tabela nr. 2 - Pasqyrë krahasimore mbi aktivitetet/masat në ngritjen e sigurisë rrugore

Stacionet	Patrullimet me automjet		Patrullimet këmbë		Pikat e kontrollit		Gjobat e trafikut	
	Janar-shtator 2022	Janar-shtator 2023	Janar-shtator 2022	Janar-shtator 2023	Janar-shtator 2022	Janar-shtator 2023	Janar-shtator 2022	Janar-shtator 2023
Qendra	1.950	1.993	1.927	1.942	2.434	2.429	10.862	12.100
Veriu	2.348	1.438	1.313	1.440	4.185	4.475	7.307	7.427
Jugu	14.239	9.346	5.205	4.496	3.790	3.491	10.340	10.023
Totali	18.537	12.777	8.445	7.878	10.409	10.397	28.509	29.550

3.8. Fokus i inspektimit ka qenë edhe realizimi i planeve operative dhe njohja me ato që kanë qenë duke u zbatuar. Lidhur me zbatimin e aktiviteteve patrulluese në funksion të planeve operative, janë verifikuar fletë patrullat e ekipeve patrulluese të ndërrimeve në periudhën kohore 10.09.2023- 22.09.2023. Gjatë periudhës sa ka zgjatur inspektimi, stacionet kanë realizuar aktivitete patrulluese në zbatim të një mori planesh operative nga fusha e ngritjes së masave të sigurisë në komunikacionin rrugor:

- Prishtinë - Qendra gjatë kësaj periudhe referuese ka qenë duke realizuar aktivitete operative në zbatim të pesë (5) planeve operative, si: “Sezona Verore”, “Siguria në Trafik”, “Goditja”, “Targeti” dhe “Parandalimi i aksidenteve dhe kontrolli i shtuar i motoçikletave”.
- Prishtinë – Veriu ka qenë duke realizuar aktivitete operative në zbatim të katër (4) planeve operative, si: “Shtimi i masave të sigurisë”, “Siguria në trafikun rrugor 2023”, “Goditja” dhe “Targeti”.
- Prishtinë - Jugu ka qenë duke realizuar aktivitete operative në zbatim të katër (4) planeve operative, si: “Siguria në trafik”, “Parandalimi i aksidenteve në trafik”, “Targeti 2023”, si dhe “Kontrolli i shtuar i trafikut në zbulimin e kundërvajtjeve, ngasja nën ndikim të alkoolit”.
- Njësi i Trafikut për Kryeqytet ka qenë duke realizuar aktivitete operative në zbatim të Planit Operativ “Rrugët e sigurta për nxënësit”.

Përfundim



Bazuar në gjetje te inspektimit, IPK vlerëson se:

- (a) Monitorimi i rrugëve në disa zona të Kryeqytetit vë pah ndikimin e sërë faktorësh dukurish në rëndimin e funksionimit normal të trafikut rrugor, për të cilat Policia nuk mund të ofroj zgjidhje si e vetme. Si rezultat i ndikimeve vështirësohet edhe qarkullimi i mjeteve/këmbësorëve, ku shtohen edhe thirrjet për reagim policor.
- (b) Vështirësitë në qarkullimin rrugor gjatë ditëve të punës vjen si rezultat i numrit të madh të automjeteve, infrastrukturës së mangët rrugore, punimeve në rrugë, si dhe ndalesave/parkingjeve të parregullta të mjeteve nëpër skajet rrugëve.
- (c) Për shkak të problematikave të shumta në trafik, nevojat kërkojnë prezencë më të shtuar të njërive policore, me qëllim të lehtësimit të lëvizjes dhe parandalimit të aksidenteve.

- (d) Gjatë aktiviteteve patrulluese të njësive policore vërehet mungesë e gatishmërisë së tyre që të reagojnë ndaj ngasësve që parkojnë mjetet në mënyrë të parregullt në vende të ndaluara (kryesisht në trotuare) duke vështirësuar qarkullimin rrugor.
- (e) Në rastet e aksidenteve të hasura, ekipet patrulluese u janë përgjigjur thirrjeve me reagim brenda një kohe relativisht të shkurtër, ku edhe i kanë trajtuar ato.
- (f) Policia ofron shërbim në zonën gjeografike të Kryeqytetit duke angazhuar burime nga radhët e tre (3) stacioneve të rendit dhe Njesisë së Trafikut për Kryeqytet. Kapacitetet policore janë ndarë varësisht faktorëve ndikues, zonave dhe ngarkesës në punë.
- (g) Menaxhimi i burimeve njerëzore brenda kapaciteteve ekzistuese është i sfiduar dhe shpesh ka vështirësi në organizimin e mjaftueshëm të njësive patrulluese për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave.
- (h) Është e evidente cilësia e ulët e evidencës së logut operacional në të tre stacionet e inspektuara, përkundër rekomandimit të dhënë më parë nga IPK-ja për ngritjen e cilësisë së tyre. Logjet nuk kanë shënime të mjaftueshme dhe lidhur me shumë thirrje mungojnë të dhëna mbi veprimet operative. Në kuadër të NJRTR- Prishtinë (Njesisë së Trafikut për Kryeqytet) nuk aplikohet mbajtje e logut operacional fare.
- (i) Stacionet policore në Prishtinë (Qendra, Veriu, Jugu) kanë ngarkesë të madhe me numrin e thirrjeve të qytetareve, që kërkojnë ndihmë policore. Numrin e thirrjeve e shtojnë thirrjet për parkime të parregullta dhe bllokimet e mjeteve në parkingje.
- (j) Janë evidentuar edhe situata kur stacionet policore për shkak të numrit të madh të thirrjeve dhe në mungesë të njësive patrulluese, i kanë vonuar intervenimet, kurse në disa situata edhe nuk kanë reaguar fare. Mos reagimi policor ndodhë për shkak të mungesës në dispozicion të njësive policore dhe kryesisht për thirrje për parkim të parregullt dhe bllokim të mjeteve në parkingje. Në këto situata thirrjet trajtohen sipas prioritetit.
- (k) Është evidentuar një dukuri (e shndërruar në praktikë) për thirrjet që pranohen në orën e përfundimit të ndërrimeve, ku reagimet policore në thirrjet e qytetarëve iu barten ndërrimeve pasuese, ku për rrjedhojë shfaqen vonesa në reagimin me kohë.
- (l) Rezultatet e matjeve për kohën e reagimit mesatar të njësive dhe arritjen e tyre në vendngjarje për thirrjet e tipit “aksident” dhe “komunikacion” për tre (3) stacionet rezultojnë të jenë të njëjta (nga 16.6 deri në 18.9 minuta).
- (m) Ekipet patrulluese të stacioneve dhe Njesisë së Trafikut për Kryeqytetin aplikojnë raportime të rregullta me fletë patrulla për aktivitetet ditore në kuadër të ndërrimit, të cilat bëhen pjesë e Raportit 24 orësh.
- (n) Sa i përket performancës së përgjithshme të stacioneve policore lidhur patrullimet me automjete, patrullimet në këmbë, pikat e kontrollit dhe gjobat e trafikut, tre (3) nga këta katër (4) indikatorë matës tregojnë trend rënës të performancës në nëntëmujorin e këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraparak. Qendra ka raportin e këtyre indikatorëve 3(+):1(-), Veriu 3(+):1(-), kurse Jugu 0(+):4(-). Jugu dhe Veriu shënojnë rënie të numrit të patrullimeve me automjete, për shkak të numrit të vogël të automjeteve.
- (o) Njësitë policore të stacioneve policore kanë qenë duke ndërmarrë aktivitete dhe veprime operative në përmbushje të një numri të konsideruar të planeve operative.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore ⁶ (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore (Qendra, Jugu dhe Veriu të Prishtinës) dhe Udhëheqësit të Njesisë së Trafikut për Kryeqytetin, të mobilizohen në shtimin e aktiviteteve patrulluese në akset kryesore të Kryeqytetit, që shfaqin vështirësi në qarkullimin normal të komunikacionit rrugor.</i>	-1-	<i>Në vazhdimësi bëhen analiza dhe pastaj planifikohet në planin e veprimit javor, por për shkak ngjarjeve të pa planifikuara që mund të ndodhin në çdo moment nganjëherë ndryshon gjendjen dhe prezencën policore në teren. Angazhimi në plane të ndryshme aktive P.O.: Siguria në trafikun rrugor, Siguria në shkollë, Realizimi i urdhërësive, Protesta të ndryshme, Lëshime kërkuesit 2023, Parandalimi i VP penale Vjedhja/Vjedhja e Rende/Grabitja, PO "Kulti", PO "Festo me zemër jo me armë, Protestë e veteranëve OVL-UÇK. Pastaj angazhime po thuaj se në baza ditore në përcjellje dhe siguri të marshutës së diplomatëve të huaj të cilët vizitojnë Kosovën. Gjithashtu asistimet në aktivitetet kulturore e sportive, të ndeshjeve ndërkombëtare në futboll e sporte të tjera. Asistencë SHKK-së, Asistime inspektorëve komunal, Sigurime në QKUK të viktimave dhe të dyshuarve nga mbarë Kosova. Asistencë Përmbaresit Privat, Asistencë tek Pallati i Drejtësisë etj. Pastaj problematika në krijimin e tollove në komunikacionin rrugor paraqet infrastruktura rrugore dhe bllokimi i disa segmenteve për qarkullim të automjeteve, të cilat interferojnë në segmentet rrugore që ju keni potencuar me të drejtë në raportin e inspektimit.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
2.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore (Qendra, Jugu dhe Veriu) dhe Udhëheqësit të Njesisë së Trafikut për Kryeqytetin, që të nxisin njësitë patrulluese në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme operative ndaj ngasësve të mjeteve që parkojnë mjetet në mënyrë të parregullt në vendet e ndaluara</i>	-1-	<i>Gjatë periudhës kohore të inspektimit nga IPK-ja, Policia në kryeqytet për parkingje të parregullta ka shqiptuar 1.248 fletëparaqitje dhe 30 vetura të konfiskuara. Megjithatë do të shtojmë aktivitetet dhe prezencën policore në segmente rrugore të përmendura në raport të inspektimit, por jo vetëm.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>

⁶ Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmbyllës të datës 21.12.2023, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

	<i>(veçanërisht në trotuaret e dedikuara për këmbësorë).</i>			
3.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës (Qendra, Veriu dhe Jugu), që të ndërmarrin veprimet e nevojshme mbikëqyrëse mbi zyrtarët e bazave të radio-komunikimit, për përmirësimin e cilësisë së logut operacional, drejt eliminimit të mangësive për evidentimin e plotë të shënimeve brenda tij.</i>	-1-	<i>Ne duke shtuar mbikëqyrjen dhe monitorimin e përpilimit të Logut Operacional me fokus në saktësinë e shënimeve e sidomos ne hapjen dhe mbylljen e logut e cila saktëson edhe kohën e reagimit, kemi ndikuar pozitivisht dhe koha e reagimit sa ishte në vitin e kaluar dhe kohën e inspektimit tuaj nga 18 minuta e kemi shkurtuar në 12 minuta gjatë muajit Nëntor. Për të përmirësuar edhe më shumë gjendjen, ne do të organizojmë edhe trajnime për zyrtarët e komunikimit. Do të shtohet inspektim në baza ditore nga shefi i operativës së stacionit policor përkatës.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
4.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës (Qendra, Veriu dhe Jugu) që të ndërmarrin masat e nevojshme të mbikëqyrjes, në drejtim të shkurtimit maksimal të kohës së reagimit (arritjes në vendngjarje) të njësisve patrulluese.</i>	-1-	<i>Nga koha apo periudha e inspektimit nga IPK-ja, tani koha e reagimit për muajt Tetor dhe Nëntor është shkurtuar nga 18 në 12 minuta. Ne do vazhdojmë të angazhohemi në vazhdimësi që koha e reagimit në vendin e ngjarjes të shkurtohet edhe më tutje.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
5.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve dhe shefave të operativës së stacioneve (Qendra, Veriu dhe Jugu), që të shtojnë mbikëqyrjen dhe të kërkojnë nga vartësit e tyre që të reagojnë shpejtë për të gjitha thirrjet e pranuar, pavarësisht momentit të pranimit të thirrjeve, kur ato të jenë edhe në fund të orarit të ndërrimit.</i>	-1-	<i>Policia e Kosovës vepron dhe iu përgjigjet thirrjeve dhe nevojave të qytetarëve në bazë të prioriteteve. Nëse në të njëjtën kohë kemi thirrje të natyrave të ndryshme për nga rëndësia, atëherë PK-ja në pamundësi me u përgjigj njëkohësisht për të gjitha thirrjet, atëherë përgjigja do të jetë në bazë të rëndësisë së rastit, përkatësisht prioritetit. Ndërsa, sa i përket vonësive në raste në fund të orarit, ne do ndërmarrim masa që një praktikë e tillë mos të përsëritet.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
6.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës së stacioneve policore (Veriu dhe Jugu) që të ndërmarrin masat e nevojshme të mbikëqyrjes mbi ekipet patrulluese, në drejtim të shtimit të patrullimeve me automjete në zonat e përgjegjësive të tyre.</i>	-1-	<i>Në periudhën e inspektimit nga IPK-ja, gjendja me vetura ishte e rënduar në DRP Prishtinë dhe në gjithë PK-në për shkak të problemeve të paraqitura në Flotë. Ndërsa, aktualisht gjendja me automjete është përmirësuar dukshëm pasi që flota është funksionale dhe falë furnizimit nga DPP-ja me disa automjete të reja. Në këtë mënyrë rrjedhimisht është bërë edhe shtimi i patrullave me</i>	<i>Në vazhdimësi</i>

			<i>automjete. Ne do vazhdojmë të monitorojmë, kontrollojmë dhe inspektojmë shpërndarjen e personelit (me vetura dhe në këmbë) varësisht nga analizat paraprake të situatës dhe kriminalitetit në zonat e caktuara.</i>	
--	--	--	--	--